URDHËR
Nr. 469, datë 9.8.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar; të pikës 2, të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285 , datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; të urdhrit nr. 3, datë 11.1.2022, "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Komisionit të Prokurimit Publik, z. Josi Ballauri, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 3.8.2026 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.
4. Delegimi i kompetencave botohet në Fletoren Zyrtare ose në Buletinin e Njoftimeve Publike.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ismail Shehu